




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-32268/23 datë: 15.12.2023



Npi – 01/481 datë: 26.12.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 26.12.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -X- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 26.12.2023 (e martë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini, DPUKGJ, z.Kastriot Shabani, DZHE, z.Bardhyl Rushiti, DSHP, nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, znj.Genta Mehmeti dhe Praktikantet znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapì, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.11.2023,
2. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale, (Pas diskutimit publik)
3. Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Pas diskutimit publik)
4. Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Pas diskutimit publik)
5. **Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2024,**
6. Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)
7. Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i urojë mirëseardhje në KPF znj.Zejnije Veliut.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, propozojë që pika e 5 me u largu nga rendi i ditës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe unë jam i mendimit që të hiqet, sepse Komisioni sot e ka mbledhjen.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës pa pikën e 5 si vijon:**

1. **Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.11.2023,**
2. **Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale, (Pas diskutimit publik)**
3. **Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Pas diskutimit publik)**

4. **Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Pas diskutimit publik)**
5. **Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)**
6. **Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.11.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 23.11.2023.**

Pika 2

Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Grejtalb Eminit.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, e kemi organizuar diskutimin publik, nuk jemi të kënaqur me pjesëmarrje por ky problem është në krejt Komunitat e pastaj po dalin problemet pas miratimit të rregullores. Propozime konkrete nuk kemi pas. Baza ligjore është dhënë me ligjin për dhënjën e tokës në shfrytëzim. Nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, sipas ligjit Komuna ka drejtë me dhënë tokën në shfrytëzim deri në një vitë. Drejtori tha se nuk jemi të kënaqur me pjesëmarrjen në debatin publik, ne si PDK e përkrahim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme Komunale për më pak se një vit.**

Pika 3

Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk paskemi përfaqësuesen e drejtorisë, por materialin e keni marrë. **z.Lumni Amrushi;** Përshëndetje, kemi pas nevojë për një rregullore të tillë. Materialin nuk e kam analizuar mirë por e mira është që nuk lejon favorizimin e ndonjë sporti.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport.**

Pika 4

Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Kastriot Shabanit.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, ne e kemi organizuar debatin publik me qytetarë, mirëpo nuk kemi pasur ndonjë propozim konkret që ja vlen për ta përfshirë në dokument. Jam i kënaqur me kompaninë që e ka hartuar Draft-Strategjinë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Shtimes për 4 vitet e ardhëshme. Është mirë që tani e kemi edhe Zonën e Ekonomike në Gllavicë, ju falënderoj dhe ju ftoj që ta votoni këtë Strategji.

z.Përparim Ramusa; E falenderoj drejtorin për punën e bërë dhe e përkrahim, shpresoj të fillojë me implementimin e sajë sa më parë. Pyetje ekspertët a janë inkorporuar në Strategji?

znj.Adelina Beqaj; Të komplimentojë për punën e bërë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Shtimes për periudhën 2024-2027.**

Pika 5

Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft- Programin Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtorja për Shërbime Publike, Zyra e Kryetarit dhe Zyra për Informim.**

Pika 6

Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Nuk kam shumë me shtu, materialin e keni marrë me kohë, ky draft duhet të del në diskutim publik. Ne e kemi një peticion nga bizneset që ta kenë pushim ditën e dielë. Po ashtu jemi bazuar dhe te praktikat e Komunave tjera. Nëse dikush ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Duhet të analizohet mirë nëse është në përputhje me ligjin, sepse ne jemi që ta përkrahim këtë rregullore.

znj.Adelina Beqaj; Nga ana ime e keni përkrahjen për një rregullore të tillë, sepse unë kam dashur me e ngritë në Kuvend por unë e kam parë që po e bëni një rregullore të tillë.

z.Kadri Emini; Në asnjë mënyrë Komuna nuk ka të drejtë me ja kufizuar orarin e punës bizneseve. Unë nuk besoj se ka bazë ligjore.

z.Përparim Ramusa; Vullneti është për me bë një orarë të tillë. Dhe ne jemi për me ju dalë krahe punëtorëve.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Është kompetencë e nivelit qendror, por nëse ka mirëkuptim.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje, është mirë me shiku anën ligjore, ata vetë paskan kërkuar.

z.Kadri Emini; Nëse pas vendimit për pushim ditën e dielë edhe e hapë njëri nga bizneset, çka do të bëjmë kur nuk kemi mekanizma për shqiptimin e denimit nga Inspektorati.

z.Lumni Amrushi; Ne si Shtime e kemi si specifike ditën e premtë për shkak të tregut që më parë ka qenë 50 me 50%.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 10:58h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

